# UDHËZIM
## Nr. 7, datë 27.3.2023

## PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 35, DATË 21.9.2020, "PËR KONTROLLIN, REGJISTRIMIN, PËRDORIMIN, RAKORDIMIN, RAPORTIMIN DHE PUBLIKIMIN E FONDEVE TË FINANCIMEVE TË HUAJA NË KUADRIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE"

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", në kushtet kur institucionet e pavaruara nënshkruajnë marrëveshje dhurimi/granti me institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, ministri përgjegjës për financat e qeverisë,

UDHËZON:

1. Pas paragrafit 4.2 të udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", shtohet paragrafi i mëposhtëm:

4.2 – ........

Përjashtim nga ky rregull bëjnë institucionet e pavarura të cilat nënshkruajnë marrëveshje dhurimi/granti nga institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, vetëm kur këto marrëveshje nuk parashikojnë angazhime shtesë për buxhetin e shtetit apo nuk janë të parashikuara në buxhetin e institucionit përkatës.

Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale të projekteve të huaja në Bankën e Shqipërisë nga nëpunësi autorizues i institucionit të pavarur/njësisë së zbatimit të projektit të financimit të huaj grant urdhërohet nga ministri përgjegjës për financat dhe i adresohet strukturës përgjegjëse për Thesarin sipas formatit në aneksin nr. 4.2 bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen institucionet e pavarura dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
**Delina Ibrahimaj**

0 Shtese udhez FH grant marreveshje teknike - Microsoft Word (Product Activation Failed)

**UDHËZIM**
**Nr. 7, datë 27.3.2023**

**PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 35, DATË 21.09.2020 "PËR KONTROLLIN, RREGJISTRIMIN, PËRDORIMIN, RAKORDIMIN, RAPORTIMIN DHE PUBLIKIMIN E FONDEVE TË FINANCIMEVE TË HUAJA NË KUADRIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE"**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, udhëzimit nr. 35 (prot 17416), datë 21.09.2020 "Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", në kushtet kur institucionet e pavaruara nënshkruajnë marrëveshje dhurimi/granti me institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, ministri përgjegjës për financat e qeverisë,

UDHËZON:

1. Pas paragrafit 4.2 të udhëzimit nr. 35 (prot 17416), datë 21.09.2020 "Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", shtohet paragrafi i mëposhtëm:

4.2 – ........

Përjashtim nga ky rregull bëjnë institucionet e pavaruara të cilat nënshkruajnë marrëveshje dhurimi/granti nga institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, vetëm kur këto marrëveshje nuk parashikojnë angazhime shtesë për buxhetin e shtetit apo nuk janë të parashikuara në buxhetin e institucionit përkatës.

Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale të projekteve të huaja në Bankën e Shqipërisë nga nëpunësi autorizues i institucionit të pavarur/njësisë së zbatimit të projektit të financimit të huaj grant urdhërohet nga ministri përgjegjës për financat dhe i adresohet strukturës përgjegjëse për Thesarin sipas formatit në aneksin nr. 4.2 bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen institucionet e pavaruara dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR
**Delina Ibrahimaj**

**ANEKS 4.2**

**Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë**

I. Kërkesa e NJZP për DPThesarit:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

________________

Nr. ___ Prot. Tiranë, më __/__/ 2023

Lënda: Kërkesë për çelje llogarie speciale

Referencë:

**Z/ZNJ.____________**
**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**ADRESA: BLV "DËSHMORËT E KOMBIT", NR. 3, TIRANË**

I/E nderuar ______,

Mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj", ju paraqesim kërkesën për çeljen e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin "… Leader x%" me specifikimet e mëposhtme:

a) Emërtimi i llogarisë që kërkohet të hapet (i njëjtë me emërtimin e projektit);
b) Lloji i financimit (grant ose kredi);
c) Emërtimi i donatorit ose kreditorit;
ç) Monedha e disbursimit;
d) Shuma e financimit të huaj;
dh) Shuma e transhit të parë;
e) Koha e përafërt kur mbërrin transhi i parë;
f) Kontakt email/telefon

Kërkesa bazohet në marrëveshjen teknike të dhurimit/grantit të nënshkruar me institucionet ndërkombëtare dhe qeveritë e shteteve të huaja, e cilat gjenden bashkëlidhur kësaj kërkese.

Lutemi njoftimin e numrit të llogarisë në momentin e çeljes pranë institucionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**TITULLARI**
**Emër Mbiemër**
**Firmë**